

# STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## KREU I

### EMERTIMI – SELIA – OBEKTI – KOHEZGJATJA

#### NENI 1

#### EMERTIMI

Shoqeria eshte krijuar ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar me date 11/ 09/2019.

Emertimi i shoqerise eshte "E REJA CONSTRUCTION Shpk". (ne vijim e quajtur "Shoqeria").

1.1 Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2018 "Per Tregtaret dhe Shoqerte Tregtare" (Ligji Tregtar"), legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me kete Statut.

#### NENI 2

#### SELIA

Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen : "Tirane; TIRANE; Kashar; MEZEZ; Rruga Pavarsia, Mëzez-Kodër, Nr.8, Zona Kadastrale 2679, mbrapa Qendres Tregtare "Casa Italia";

Shoqeria mund te krijojë dege, zyra, filiale dhe te zhvillojë aktivitet ne vende te tjera, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise me vendim te Administratorit te Vetem/Keshillit Administrativ ose te Kryetarit te ketij Keshilli, nese ky i fundit eshte autorizuar per kete qellim nga Keshilli Administrativ.

#### NENI 3

#### OBJEKTI I SHOQERISE

3.1 Shoqeria ka per objekt dhe qellim te saj aktivitetet e meposhtme :

- a) Punime te ndryshme ne fushen e ndertimit;
- b) Punime hidroteknike, linja tensioni te larte e tensioni te ulet;
- c) Punime germimi ne toke, ndertime civile e industriale, rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje, fasada, rruge autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale, punime nentokesore, ura dhe vepra arti, ujesjellsa, gazsjelles, vajsjelles, vepra kullimi e vaditje, punime per prishjen e ndertimeve, impjant hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre;
- d) Ndertim dhe rikonstrukcion objektesh civile, industrial, bujqesore, turistike dhe cdo lloj objekti te natyrave te tjera;
- e) Tregti me shumice dhe pakice materiale ndertimi, inerteve, materialeve elektrike, hidraulike e hidrosanitare, linja per prodhim materialesh ndertimi si tulle, tjegulla, pllaka, tubacione, shtylla elektrike si dhe cdo lloj tjeter prodhim betoni.
- f) Nxjerrje, transport dhe tregtim lendesh minerare;
- g) Sherbime transporti;
- h) Import – Eksport;
- i) Tregtim e shitje makinash, makinerish dhe pajisjesh te ndryshme;



- j) Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture te natyres teknike ndertuese, sinjalistike rrugore jo ndricuese, barrier dhe mbrojtje rrugore ndertime parafabrikate.

3.2 Me qellim realizimin e objektit te aktivitetit te saj Shoqeria mund te kryeje operacione tregtare me pasuri te paluajtshme dhe te luajtshme, si dhe te administroje, te bleje, te shese, te jap me qira si dhe te kete interesa pjesemarrje ne Shoqeri, konsorciume te themeluar apo ne them elim e siper, qe kane objekt te ngjashem me objektin e aktivitetit te shoqerise, ose qe I sherben realizimit te ketij objekti. Ne pergjithesi, Shoqeria mund te kryeje cdo veprimtari te nevojshme e te dobishme, te lejuar nga ligji per realizimin e objektivave te saj.

#### NENI 4

#### KOHEZGJATJA

4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje kohezgjatje te pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar te Republikes se Shqiperise.

4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqerise do te percaktohet me vendim te Ortakut te Vetem/Asamblese se Ortakeve ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe legjislacionit ne fuqi.

#### KREU II

#### KAPITALI

#### NENI 5

#### KAPITALI

5.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte ne vleren 100'000 Leke (njqind mije leke) i investuar ne masen 100% nga Ortaku i Vetem, i ndare ne 1 (nje) kuote, me vlere nominale 100'000 Leke (njqind mije leke). Kapitali Themeltar, eshte teresisht i nenshkruar nga Ramiz Byberi (Ortak i Vetem).

5.2 Kapitali i Shoqerise do te paguhet ne llogarine bankare te Shoqerise.

5.3 Kapitali i Shoqerise zmadhohet ose zvogelohet nen minimumin e parashikuar ne ligj, per shkak te humbjeve te Shoqerise, ose nese kjo e fundit duhet te rfinancohet nga ortaku ne menyre qe te vendose garancine e leshuar nga ortaku per Banken Intesa Sanpaolo Bank, Shqiperi, ne emer dhe per llogari te Shoqerise, kuorumi dhe shumica e nevojshme per miratimin e rritjes se kapitalit do te zvogelohet ne minimumin e percaktuar nga ligji.

#### NENI 6

#### ORTAKET

6.1 Ortaku I Vetem i Shoqerise eshte:

1. Ramiz Byberi, Atesia Qazim, i datelindjes 17.08.1961, lindur ne Shoshan, Tropoje, dhe banues ne Lagjia 13, Plazh, Durres, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I leternjofimit me numer unik identifikimi NID G10817035Q qe perfaqeson 100% te kapitalit te Shoqerise.

6.2 Hyrja ne Shoqeri e ortakeve te rinj si pasoje e trashegimise ose transferimit te kuotave tek pale te treta do te behet ne perputhje me parashikimet e nenit 8 te ketij Statuti. Cdo ndryshim ne lidhje me sa me lart do vendoset



nga Ortaku i Vetem/ Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me kuorumin dhe shumicen e percaktuar ne nenin 10.3 te ketij Statuti dhe do t'i njoftohet Qendres Kombetare te Biznesit per qellime regjistrimi.

6.3 Asambleja e Ortakeve dhe Administratoreve per efekt te marredhenieve te tyre me shoqerine, eshte ajo qe rezulton nga regjistri i ortakeve. Eshte detyrim i ortakeve te njoftojne ndryshimin e adreses se tyre. Administratori (et) kane per detyre te mbajne dhe perditesojne kete regjister.

#### NENI 7

##### KONTRIBUTET DHE FINANCIMET

7.1 Kontributi i ortakut ne kapitalin e Shoqerise mund te jete ne para ose ne natyre, si pasuri te luajtshme, te paluajtshme apo te drejta.

#### NENI 8

##### TRANSFERIMI I KUTOVE DHE E DREJTA E PARABLERJES

8.1 Dispozita e ketij neni te Statutit kane per qellim mbrojtjen e interesave te Shoqerise, unitetit te ortakeve dhe ekulibrit te marredhenieve midis tyre dhe per kete arsye vendosen kufizimet e meposhtme ne rastin e transferimit te kuotave.

8.2 Kuotat jane lirisht te transferueshme; (i) midis ortakeve dhe bashkeshorteve apo femijeve te tyre (ii) midis ortakeve dhe Shoqerive te kontrolluara nga ortakët ose shoqerive kontrolluese te ortakeve (iii) midis ortakeve.

8.3 Kuotat jane lirisht te transferueshme me testament ose nepermjet trashegimise ligjore nga ortaku tek bashkeshorti/ja apo femijet (Trashegimtarete e Njohur). Ne rast se kuotat e perfituara nepermjet trashegimise, zoterohen nga me shume se nje Trashegimtar i Njohur, te drejtat e Trashegimtareve te lidhura dhe qe rrjedhin nga keto kuota do te ushtrohen nga nje perfaqesues i perbashket i trashegimtareve. Ne rast se kuotat do te transferohen tek nje trashegimtar i ndryshem nga Trashegimtari i njohur, Shoqeria ruan te drejten te riblerje keto kuota nga trashegimtari ne fjale me nje vlere te percaktuar nga eksperti i caktuar per kete qellim. Kjo riblerje do te realizohet brenda nje viti nga transferimi i kuotave tek ky trashegimtar. Ky parashikim nuk do te zbatohet ne rast se ortakët e Shoqerise me vendim unanimit pranojne si ortak te Shoqerise keto Trashegimtar.

#### KREU III

#### NENI 9

##### ASAMBLEJA E ORTAKEVE DHE KOMPETENCAT E SAJ

9.1 Ne baze te ligjeve dhe dispozitave te ketij Statuti, Ortaku i Vetem ose Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te Shoqerise eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise.

Vendimet per ceshtjet e meposhtme te Shoqerise mund te miratohen ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te ortakeve ose nepermjet konsultimit me shkrim:

- a) Percaktimi i politikave tregtare te Shoqerise,
- b) Miratimi i ndryshimeve te Statutit,
- c) Emerimi e shkarkimi i antareve te Keshillit Administrativ/Administratoreve si dhe percaktimi i kompetencave dhe shperblimit te tyre,
- d) Emerimi e shkarkimi i likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar si dhe percaktimi i shperblimit te tyre,



- e) Mbykqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga Keshilli Administrativ/Administratores, përfshirë mbikqyrjen e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- f) Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të ecurisë së veprimtarisë pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatës dhe brenda gjashtë muajsh nga perfundimi i vitit financiar,
- g) Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit të shoqërisë pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatës,
- h) Pjesëtimi i kuotave dhe anulimi i tyre,
- i) Caktimi i përfaqësuesit të Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj anëtarëve të Keshillit Administrativ/Administratorit të Vetem
- j) Miratimi i riorganizimit të Shoqërisë, përfshirë bashkimin me Shoqëri të tjera, ndarjen e shoqërisë, shndërrimin e Shoqërisë si dhe prishjen e saj.
- k) Miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Ortakëve.

#### NENI 10

#### THIRRJA E ASAMBLESE SË PERGJITHSHME

10.1 Asambleja e përgjithshme e ortakëve duhet të thirret ta pakten një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e pasqyrave financiare dhe raportit të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë të hartuar nga Keshilli Administrativ/Administratori i Vetem, si dhe çdo herë që gjykohej e nevojshme nga Administratori i Vetem /Kryetari i Keshillit Administrativ ose nga të pakten dy anëtarë të Keshillit Administrativ.

10.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mbledhet në selinë ligjore apo pranë një vendi tjetër brenda ose jashtë Shqipërisë

10.3 Kryetari i mbledhjes emëron sekretarin, i cili harton procesverbalin e mbledhjes së Asamblesë.

10.4 Ortaket mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë nëpërmjet mjeteve elektronike si telekonferenca, video-konferenca apo komunikimit video-shkrues.

10.5 Përdorimi i mjeteve elektronike do të kryhet duke marrë të gjitha masat teknike të nevojshme për garantimin e identifikimit të ortakëve, si dhe sigurinë e këtyre mjeteve elektronike. Në vecanti është e nevojshme që :

(i) Kryetari i Mbledhjes të ketë mundësinë të verifikojë dhe të identifikojë ortaket të cilët janë të pranishëm, të kontrollojë mbarevajtjen e mbledhjes, të numërojë dhe të shpallë rezultatin e votimit,

(ii) Sekretari dhe/ose mbajtësi i procesverbalit të ketë mundësinë për tu njohur me faktet dhe ngjarjet e ndodhura në mbledhjen, objekt të procesverbalit,

(iii) Të mundësohet pjesëmarrja e të gjithë të pranishmëve për të diskutuar mbi rendin e ditës, në shqyrtimin, marrjen dhe shpërndarjen e të gjitha dokumentave të përdorura gjatë mbledhjes si dhe në procesin e votimit mbi rendin e ditës.

10.6 Mbledhja e Asamblesë, konsiderohet rregullisht e mbajtur në vendin ku është i pranishëm Kryetari i Mbledhjes, Sekretari ose mbajtësi i Procesverbalit, i cili ben të mundur përgatitjen dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.

10.7 Kryetari i mbledhjes do të verifikojë identitetin e çdo ortaku pjesëmarrës ose përfaqësuesve të tyre.

10.8 Ne rast se ortakët janë të ftuar të marrin vendime nepermjet konsultimit me shkrim, kuorumi do të quhet si i formuar bazuar në numrin e ortakëve që do të dergojnë votimin dhe vendimet e tyre me shkrim. Administratori i Vetem/Kryetari i Keshillit Administrativ ose anëtarë të tjerë të Keshillit Administrativ ose Ortakët e Pakicës që kërkojnë vendimmarrjen duhet të dergojnë cdo ortakë njoftimin për konsultimin me shkrim, i cili do të përmbajë gjithë informacionet që përfshihen në letren e njoftimit/thirrjes të përcaktuar në Ligj . Procedura e konsultimit me shkrim duhet të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore. Cdo ortakë duhet të shprehet me shkrim në lidhje me projekt-vendimet duke votuar mbi dokumentin e projekt vendimeve në formën e derguar nga Administratori/et, nepermjet shenimit "pro" ose "kunder" ose duke shprehur komentet e tyre në një dokument tjetër. Në rastin e ortakëve që kanë komente, duhet t'u bëjnë referencë të qarta projekt-vendimeve. Secili ortakë duhet t'i dergojë Administratorit të Vetem/Kryetarit të Keshillit Administrativ apo anëtarëve të Keshillit Administrativ ose Ortakëve të Pakicës që kanë kërkuar marrjen e vendimit nepermjet keshillimit me shkrim, votën e tij/ vendimet me shkrim brenda datës së përcaktuar në njoftimin e derguar për marrjen e vendimit nepermjet konsultimit me shkrim.

10.9 Vendimet e Ortakut të vetem duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes të hartuar nga Sekretari i Mbledhjes. Gjithashtu ky procesverbal duhet të pasqyrojë në mënyrën e organizimit të mbledhjes së asamblese apo të konsultimit me shkrim nëse është kryer në përputhje me ligjin dhe dispozitat e Statutit, si dhe nëse vendimet konsiderohen të miratura sipas votave të marra. Procesverbali do të nënshkruhet nga Kryetari dhe sekretari i mbledhjes. Procesverbali dhe njoftimi i thirrjes së Asamblese i dergohet Keshillit Administrativ/Administratorit të Vetem, i cili i mban këto akte në selinë e Shoqërisë. Nëse vendimet e marra nga Ortaku i Vetem duhet të depozitohen pranë Regjistratit Tregtar, procesverbali i mbledhjes do të shërbejë si dokument që provon të dhënat që do të depozitohen në këtë regjistër.

10.10 Në rast se Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk mund të shqyrtojë në të njëjtën ditë të gjitha çështjet që duhen diskutuar, vazhdimi i mbledhjes do të bëhet në nesermen pa pasur nevojë për njoftim të mëtejshëm.

#### KREU IV

#### ADMINISTRIMI I SHOQËRISE

#### NENI 11


#### KESHILLI ADMINISTRATIV/ADMINISTRATORET

11.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator, pa kufizim në lidhje me shtetësinë e tij.

11.2 Administratori do të ketë kompetencë me të gjera për vendimmarrjen e zakonshme dhe të jashtëzakonshme dhe në administrimin e shoqërisë dhe mund të marrë cdo veprim që konsiderohet i nevojshëm për të realizuar objektin e aktivitetit të Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji dhe Statuti ia njeh ekskluzivisht Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve.

11.3 Në vecanti Administratori ka këto kompetencë për të ndermarr veprimet si vijon: të vendosë për kryerjen e transaksioneve me asetet dhe/ose aktivitetin e shoqërisë, pavarësisht nga vlera e aseteve/aktivitetit të përfshirë në këto transaksione, të vendosë në emër të shoqërisë për marrjen e huave dhe/ose vendosjen e garancive të çfaredolloji, qoftë në formën e hipotekës, barreve siguruese dhe cdo lloj garancie tjetër me bankat dhe/ose institucionet financiare pa kufizime në shumën, me kushtin që këto transaksione të jenë në përputhje me strategjinë tregtare dhe planet e investimit, pjesëmarrjen në tendera/procedura konkurruese dhe nënshkrimin e cdo lloj marrëveshjeje dhe kontrate me paletë e treta për realizimin e objektit të aktivitetit të shoqërisë.

11.4 Kufizimi i përcaktuar në nenin 17 të Ligjit Tregtar nuk është i zbatueshëm dhe Administratori i Shoqërisë mund të emërohet në funksione drejtuese në shoqëri të tjera tregtare të angazhuara në të njëjtën fushë aktiviteti si shoqëria, nëse janë të autorizuar me vendim të Asamblese së Përgjithshme të ortakëve në momentin e emërimit të tij. Pavarësisht nga sa më lart, anëtarët e mëposhtëm të Keshillit administrativ/Administratoret janë



te autorizuar shprehimisht te mbajne funksione drejtuese ne shoqerite e tjera, me perjashtim te rasteve kur keto Shoqeri jane te kontrolluara nga Shoqeria, ose ushtrojne kontroll mbi kete te fundit.

11.5 Administrator eshte:

Ramiz Byberi, i datelindjes 17.08.1961, lindur ne Shoshan, Tropoje, dhe banues ne Lagjia 13, Plazh, Durres, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I leternjoftimit me numer unik identifikimi NID G10817035Q.

11.6 Shkarkimi I Administratorit dhe emerimi i administratoreve te rinj nuk do te perbeje ndryshim ne kete Statut, per cdo ndryshim ne lidhje me sa me lart do te vendoset nga Ortaku i vetem/Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve dhe do te njoftohet ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Tregtare te Biznesit per qellim regjistrimi.

## NENI 12

### ORGANIZIMI I MBLEDHJES SE KESHILLIT ADMINISTRATIV

12.1 Ne rast se ne momentin e emerimit te Keshillit Administrativ, ortaket nuk kane emeruar Kryetarin e Keshillit Administrativ, ky i fundit zgjedh nje prej antareve te tij ne cilesine e Kryetarit dhe nese e konsideron te pershtatshme emerone dhe nje zevendes-Kryetar i cili zvendeson Kryetarin Administrativ, i cili mund te zgjidhet dhe jashte radheve te anataresise se Keshillit.

12.2 Kryetari me iniciativen e tij, mbledh Keshillin Administrativ, cakton rendin e dites, kordonin punet dhe kujdeset qe Administratoret te jene te informuar rregullisht per ceshtjet ne shqyrtim. Keshilli Administrativ mblidhet ne rastet kur mbledhja e tij kerkohet me shkrim nga te pakten dy antare te Keshillit.

12.3 Mbledhja e Keshillit Administrativ thirret nepermjet e-mailit ose ne forme tjeter njoftimi me date zyrtar, i cili i drejtohet cdo antari te Keshillit te pakten 5 (pese) dite perpara dates se mbledhjes. Kur mbledhja eshte urgjente njoftimi dergohet te pakten 2 (dy) dite perpara dates se takimit. Njoftimi percakton daten, oren, vendin e mbledhjes si dhe rendin e dites.

12.4 Keshilli mblidhet ne seline e Shoqerise ose jashte saj.

12.5 Vertetimi i njoftimit te mbledhjes nuk eshte i nevojshem kur jane te pranishem te gjithe Administratoret.

12.6 Vendimet e Keshillit Administrativ jane te vlefshme, kur ne mbledhje jane te pranishem shumica e antareve ne detyre. Vendimet miratohen me shumicen e votave "pro" te anetareve te pranishem ne Keshill. Ne rast barazimi te votave, vota e Kryetarit eshte percaktuese. Ne asnje rast nuk mund te votohet me akt perfaqesimi.

12.7 Kryetari i Keshillit drejton mbledhjen. Kryetari dhe Sekretari do te mbajne e nenshkruajne process-verbalin e mbledhjes. Vendimet do te regjistrohen ne regjistrin perkates te Shoqerise.

12.8 Mbledhjet e Keshillit Administrativ mund te mblidhen dhe te kryhen nepermjet telekonferences, video-konferences, apo komunikimit video shkruar, me kusht qe te jete i mundur trajtimi i barabarte i te gjithe antareve te Keshillit. Vecanerisht eshte e nevojshme qe:

12.8.1 Kryetari mund te verifikoje identitetin e antareve te Keshillit Administrativ qe jane te pranishem, te kontrolloje zhvillimin normal te takimit, te konstatoje dhe shpalle rezultatet e votimit.

12.8.2 Sekretari ose mbajtesi i procesverbalit te mund te identifikoje rregullisht ceshtjet e shkruara per diskutim qe jane objekt i procesverbalit.

12.8.3 Te mundesohet pjesemarrja e anetareve ne diskutimin e pikave te rendit te dites, ne marrjen dhe shqyrtimin e dokumentave te perdorura gjate mbledhjes, si dhe pjesemarrja e tyre ne votimin e rendit te dites.



12.8.4 Te percaktohet ne njoftimin e mbledhjes vendi ku Shoqeria do te vendose pajisjet e nevojshme per transmetimet audio-video dhe ku anetaret e Keshillit Administrativ do te jene te pranishem.

Mbledhja e Keshillit Administrativ ne kushtet e siperpermendura, do te konsiderohet e mbledhur rregullisht ne vendin ku ndodhen Kryetari dhe Sekretari ose mbajtessi i procesverbalit te mbledhjes, te cilet mundesojne mbajtjen dhe pergatitjen e procesverbalit te mbledhjes, me kusht qe te jene respektuar dispozitat e mesiperme.

12.9 Keshilli Administrativ mund te delegoje, sipas dispozitave ligjore, kompetencat e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem ose nje pjese te tyre te Kryetari i Keshillit Administrativ ose tek nje anetar tjetër i Keshillit Administrativ.

12.10 Organet e deleguara i raportojne te pakten nje here ne tre muaj Keshillit Administrativ per veprimet me te rendesishme ekonomike, financiare dhe pasurore te kryera nga Shoqeria. Komunikimet jepen ne mbledhjet e Keshillit Administrativ.

## NENI 12

### DISPOZITA TE PERBASHKETA PER ADMINISTRATORET

13.1 Administratori/et emerohen nga Ortaku i Vetem/Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve per nje periudhe jo me te gjate se 5 (pese) vjet, me te drejte rizgjedhjeje. Administratori/et largohet nga detyra ne daten e mbledhjes se Asamblese se Ortakeve e cila miraton pasqyrat e vitit te fundit financiar te detyres se tyre/tij, pervec se edhe ne rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

13.2 Administratoret duhet te njoftojne me shkrim doreheqjen e tyre tek Keshilli Administrativ. Doreheqja prodhon efekte te menjehershme vetem nese shumica e anetareve te Keshillit Administrativ qendron ne detyre. Ne rast te kundert, kur anetaret ne detyre te Keshillit Administrativ nuk formojne shumicen e nevojshme, doreheqja e Administratorit do te quhet efektive nga momenti i emerimit te Administratorit/eve te rinj nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

13.3 Ne rast se nje ose me shume Administratore largohen nga detyra, ata zevendesohen perkohesisht me vendim te Keshillit Administrativ. Administratori/et e emeruar ne keto rrethana qendrojne ne detyre deri ne vendimin e mbledhjes se radhes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

13.4 Ne rast se gjate mandatit, largohen nga detyra shumica e Administratoreve te emeruar nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, Administratoret ne detyre therrasin mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per te vendosur per zvendesimin e Administratoreve te larguar. Mandati i Administratoreve te rinj perfundon ne te njejten date me mandatin e Administratoreve te mbetur ne detyre.

13.5 Administratoreve u takon rimbursimi i shpenzimeve te ndermarra per arsye te detyres. Asambleja mund te caktojë shperblime te tjera, perfshire ketu dhe nje shperblim vjetor.

13.6 Cdo anetar i Keshillit Administrativ qe ka interesa personalisht ose nepermjet personave te trete, lidhur me nje aktivitet te caktuar qe bie ne kundërshtim me interesat e Shoqerise, duhet te njoftoje Keshillin Administrativ dhe nuk mund te marre pjese ne vendimarrjen ne lidhje me keto aktivitete, por prania e tij do te vlejë per efekt kuorimit te nevojshem.

13.7 Cdo anetar i Keshillit Administrativ qe personalisht ose nepermjet personave te lidhur me te sipas percaktimeve te nenit 13 te Ligjit Tregtar, ka interes ne marreveshje te cilat do te lidhen nga Shoqeria duhet te njoftoje Keshillin Administrativ dhe Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve. Vendimi per kete marreveshje duhet te miratohet paraprakisht nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.



13.8 Anetaret e Keshillit Administrativ I ushtrojne kompetencat e tyre te percaktuara ne kete Statut ne ligjet e zbatueshme ne fuqi, dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne menyre te kujdesshme dhe jane bashkarisht pergjegjes kundrejt Shoqerise per demet e shkaktuara nga moskryerja e rregullt e detyrave te tyre.

#### NENI 14

#### PERFAQESIMI

Shoqeria administratohet nga Administratori (et), te cilet mund te kryejne me vete cdo veprim qe u jep te drejte cilesia e te qenurit Administrator i shoqerise, pa nevojën e konfirmimit te administratorit tjetër, i cili (ky i fundit) di ti marre veprimet si te mireqena sikur te ishin kryer prej tij.

-Secili prej Administratoreve perfaqesues te Shoqerise ka te drejte te autorizoje me vete me prokure ligjore nje person te trete per te perfaqesuar Shoqerine, pavaresisht Administratorit tjetër.

14.1 Administratoret mund te kryejne transakcione me pale te treta dhe mund te ndermarrin veprime administrimi pa u kufizuar nga vlera e transakcioneve. Gjithashtu, Administratoret, personalisht ose nepermjet personave te autorizuar prej tij, kane te drejten te perfaqesojne Shoqerine ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve (qofshin te zakonshme apo te jashtezakonshme) te shoqerive te kontrolluara nga Shoqeria ose te shoqerive ne kapitalin e te cilave Shoqeria zoteron pjesemarrje.

14.2 Administratoret do te ushtrojne detyrat e tyre te percaktuara ne kete Statut, ligjet e zbatueshme dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne menyre te kujdesshme dhe do te jene pergjegjes kundrejt Shoqerise per demet e shkaktuara nga moskryerja e rregullt e detyrave sipas percaktimeve te nenit 16 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

#### KREU V

#### VITI USHTRIMOR –KONTROLI KONTABEL-PRISHJA DHE LIKUJDIMI

#### NENI 15

#### VITI USHTRIMOR DHE PASQYRAT FINANCIARE

15.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo vit.

15.2 Ne perfundim te cdo viti financiar, Administratoret e Shoqerise hartojne pasqyrat financiare ne perputhje me ligjin.

#### NENI 16

#### FITIMI DHE DIVIDENTET

16.1 Fitimet qe rezultojne nga pasqyrat financiare te miratura rregullisht, do t'i shperndahen Ortakut/Asambleja e Ortakeve pervec rasteve kur eshte vendosur ndryshe nga Ortaku i Vetem/Asambleja e Ortakeve per tu perdorur per qellime te tjera. Fitimi qe mund te shperndahet tek Ortaku/Asambleja e Ortakeve konsiston ne fitimin e vitit aktual, fitimin e realizuar ne vitet e kaluara dhe te mbartur, fitimi i realizuar ne vitet e kaluara i cili eshte destinuar per rezerven ligjore, kur qellimi i krijimit te rezerves ligjore, kur qellimi i krijimit te rezerves eshte permbushur dhe Ortaku i Vetem vendos te shfuqizoje rezerven ne fjale.

#### KREU VI

#### KONTROLI KONTABEL

#### NENI 17 KONTROLI





Nese kerkohet nga ligji, eksperti dhe/ose ekspertet emerohen nga Ortaku /Asambleja e Ortakeve . Ortaku i Vetem/Asambleja e Ortakeve mund te riemeroje te njejtin/et ekspert/e. Eksperti/et shkarkohet/n nga detyra me vendim te Ortakut te Vetem/Asamblese se Ortakeve ne rast mosrespektimi te detyres se tij, ne rast gabimi dhe ne rast mungese profesionalizmi ne sjellje.

PRISHJA DHE LIKUJDIMI

NENI 18

PRISHJA DHE LIKUJDIMI

18.1 Ortaku i Vetem/Asambleja e Ortakeve mund te vendose per prishjen e Shoqerise. Prishja e Shoqerise do te shoqerohet me likujdimin e saj.

18.2 Shoqeria vazhdon te ekzistoje si person juridik vetem per nevoja te likujdimit deri ne perfundim te ketij procesi dhe gjate likujdimit togfjaleshi "ne likujdim e siper" duhet te vihet pas emrit te Shoqerise.

18.3 Likujduesi/t do te emerohet me vendim te Ortakut te Vetem/Asamblese se Ortakeve. Emerimi i likujduesit/eve dhe procesi i likujdimit do te kryhen ne perputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

NENI 19

LIGJI I ZBATUESHME DHE JURIDIKSIONI

19.1 Per ceshtjet e parregulluar ne kete Statut do te zbatohet Ligji nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

19.2 Cdo konflikt, divergjence, mosmarreveshje apo pretendim i cfaredolloji, sido qe te kete lindur nga apo ne lidhje me kete Statut, do ti drejtohet dhe do zgjidhet perfundimisht nga arbitrazhi, sipas Rregullave te Arbitrazhit te Dhomes Nderkombetare te Tregtise ("Rregullat") nga nje panel i perbere prej tre arbitrash te emeruar ne perputhje me Rregullat. Gjuha e cdo gjuhe arbitrazhi do te jete gjuha angleze me perkthim simultan ne gjuhen shqipe, nese dhe atehere kur ky perkthim do te kerkohet nga cdonjera prej paleve dhe me shpenzimet e pales kerkuese. Palet heqin dore nga cdo e drejte per apelim apo reference ligjore kundrejt gjykatave, ne masen qe kjo heqje dore eshte e vlefshme. Gjykata e Arbitrazhit do te kete te drejte te jape perkohesisht cfaredolloj vendimi qe do te kishte te drejte te jepte ne vendimin perfundimtar.

Ky Statut i Shoqerise u hartua ne tre kopje ne gjuhen shqipe, me te njejten vlere secila dhe u nenshkrua rregullisht nga Ortaku i Vetem.

ORTAKU I VETEM

RAMIZ BYBERI

